



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

“PARTNERITETI PËR QEVERINË E HAPUR” 2020 – 2022”

TAKIMI I DYTË KONSULTATIV

05.10.2020

**Komponenti nr 3. “Aksesi në Drejtësi”
Hartimi i draft Planit të Veprimit**



CONSULTATION 2

Consultation Details

| | |
|------------------------------|---|
| Policy Goal Focus | Ndërtimi i një qeverie të hapur që i siguron qytetarëve të saj akses në drejtësi, transparencë dhe llogaridhënie. |
| Lead Focal Point Institution | Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë “Ministria e Drejtësisë” |
| Date | 05 Tetor 2020 |
| Consultation Meeting Number | Takimi i dytë konsultativ |

I. Objective of Consultation Meeting

| What was the aim of this consultation? Please answer for all that apply | Details |
|--|---|
| (i) Introduce stakeholders to the proposed policy goal | Qëllimi i takimit të dytë konsultativ me grupet e interesit ishte prezantimi i detajueshëm i Draftit të Planit të Veprimit të Komponentit nr. 3 “Aksesi në drejtësi” pjesë e Partneritetit për Qeverisjen e Hapur 2020-2022 si dhe marrja e mendimeve dhe sugjerimeve të pjesëmarrësve në lidhje me këtë Draft, në veçanti me politikën kryesore të Komponentit dhe objektivat e tjerë specifik. |
| (ii) Introduce stakeholders to the OGP process | Ekspertja ndërkombëtare Ms. Courtney McLaren bëri prezantimin mbi procesin e OGP dhe çfarë kërkohet konkretisht nga grupet e interesit për përmbushjen e kërkesave sipas standarteve të përcaktuara nga OGP. U ndërthur ky proces me komponentin specifik, aksesin në drejtësi, transparencën dhe llogaridhënien, U krye një ekspozë mbi të gjitha fazat e kaluara deri në këtë takim dhe u bë një njohje me dokumentet kyçe të OGP të cilat u shpërndanë pjesëmarrësve. |
| (iii) Explain the feedback tools for stakeholders | Gjatë takimit u parashtruan shembuj konkretë të problematikave të hasura, për të lehtësuar kontributin në mendime të grupeve të interesit. Pjesëmarrësit u shprehën gojarisht në lidhje me përshtypjet e tyre për procesin. |
| (iv) Brainstorm ideas with stakeholders | Pjesëmarrësit dhanë idetë e tyre konkrete për draftin e planit të veprimit dhe ku duhet të fokusohen masat specifike në përmbushje të objektivave. Për shkak të kohës së limituar disa prej pjesëmarrësve do të dërgojnë mendimet/idetë e tyre me email. |
| (v) Develop further details (milestones, etc.) for ideas | Idetë nga Akademia (Universiteti i Tiranës) ishin shumë konkrete. Ato kapën 5-6 fusha specifike të cilat do të ndikojnë në rritjen e aksesit në drejtësi dhe transparencë. Gjithashtu, mendimet nga |

| | |
|---|--|
| | Shoqëria CRCA ish in shumë të vlefshme në lidhje me aksesin në drejtësi për grupet vulnerable, si të miturit, sidomos në çështjet penale. |
| (vi) Gather feedback on proposed policy goals | Pjesëmarrësit në përgjithësi ish in dakort me politikën kryesore të Komponentit 3. Vëmendja u përqëndrua te masat konkrete për realizimin e politikës. |
| (vii) Prioritize proposed policy goals | N/A |
| (viii) Other (provide details) | N/A |

II. Methodology

| What was the format of the meeting? How were stakeholders able to participate? | Details |
|---|---|
| (i) Presentations | Takimi u krye ne sallën e konferencave në Ministrinë e Drejtësisë. Bazuar tek agenda, prezantimeve iu kushtua pjesa e parë e takimit konsultativ, rreth 1/3 e kohës. U kryen 2 prezantime: Znj.Elona Hoxha dhe Suzana Frasheri nga Ministria e Drejtësisë prezantuan në viza të përgjithshme mbi OGP. Ekspertja Ms McLaren prezantoi procesin sipas standarteve të kërkuar nga OGP në mënyrë specifike dhe u fokusua në pritshmëritë e procesit dhe cfarë kërkohet nga grupet e interesit. |
| (ii) Discussion/ Feedback from stakeholders | Rreth 2/3 e kohës së takimit konsultativ iu kushtua diskutimeve dhe reagimeve nga ana e të pranishmëve. Takimi i dytë konsultativ ishte pozitiv me prezencën e grupeve të interesuara. Si rezultat i prezencës fizike të pjesëmarrësve diskutimi pati efektshmëri më të plotë dhe përfshirja e tyre ishte shumë e kënaqshme në lidhje me synimin e takimit. Gjatë konsultimit, të pranishmit u angazhuan me pyetje dhe diskutime. |
| (iii) Questions and answers | Grupeve të interesit iu bë me dije rëndësia e dhënies së komenteve, sugjerimeve dhe ideve për ti bërë pjesë të Planit të Veprimit aktual apo të rradhës. U realizuan pyetje në momente të caktuara të konsultimit dhe u morrën përgjigje konkrete nga drejtuesit e takimit apo insitucionet e tjera si Drejtorja e Ndhmës Jurdike Falas. |
| (iv) Brainstorming | Grupet e intersit u mbështetën dhe inkurajuan për shprehjen e ideve të cilat u dhanë konkretisht dhe do jepen gjithashtu dhe nëpërmjet emailit për grupet e interesit që nuk kishin mundësi për shkak të kohës së limituar. |
| Stakeholder Selection | Details |
| (i) How were stakeholders selected? | Për realizimin e procesit u përdor lista e shoqërive civile/grupeve të intersit të cilat kanë lidhje direkte ose indirekte me aksesin në drejtësi, transparencën dhe llogaridhënien. U përfshi një pjesë e gjërë e shoqërive civile të cilët merren me vëzhgimin e veprimtarisë të institucioneve shtetërore me synim kërkimin e llogaridhënies nga ana e qeverisë, akademikë/profesor të universiteteve shtetëror dhe |

| | |
|--|---|
| | private të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre me lidhje direkte në sistemin ligjor. |
| (ii) How were stakeholders contacted? | Grupet e interesit u kontaktuan nëpërmjet adresës së email si fillim për nisjen e procesit, ku iu bë me dije adresa e internetit të OGP dhe linku për aksesimin e materialeve të hartuara për komponentin nr.3. Më pas ata u njoftuan elektronikisht për organizimin e takimit të dytë konsultues si dhe u telefonuan paraprakisht për takimin. |
| (iii) How many stakeholders were contacted? | Në total u kontaktuan rreth 25 grupe interesi me email dhe telefon. |
| (iv) Was the consultation announced publically? (via websites, social media, etc.) | Para konsultimit njoftimi nuk u publikua në rrjetet sociale. Pas realizimit të tij, Ministria e Drejtësisë publikoi zhvillimin e eventit në faqen e saj zyrtare dhe Facebook. |
| (v) Were stakeholders reminded? | Po iu dergua email kujtues dhe disa prej tyre u morrën në telefon. |

III. Results/ Findings

| Stakeholder Contributions | Details |
|--|--|
| (i) How many stakeholders attended? | Në takimin konsultativ morrën pjesë 7 grupe të interesuara. Një pjesë e konsiderueshme e përfaqësuesve të grupeve të interesit të cilët kishin konfirmuar pjesëmarrjen nuk ishin prezentë, ndoshta për shkak dhe të virusit, rrjedhimisht numri i të pranishmëve nuk ishte aq sa pritej, megjithatë të pranishmit ishin aktivë dhe u përfshinë duke shprehur sugjerimet dhe idetë e tyre konkrete në lidhje me procesin dhe masat e cituara në draftin e planit të veprimit. |
| (ii) Did stakeholders contribute? | Të pranishmit iu bashkuan diskutimit me mendime duke kontribuar nëpërmjet bashkëpunimit dhe angazhimit të tyre në këtë proces, i cili do të ndihmojë në finalizimin me sukses të këtij komponenti. Gjithashtu, u ftuan për të dërguar rekomandime me shkrim në adresat përkatëse dhe të inkurajojnë grupet e tjera të interesit për të marrë pjesë dhe shprehur kontributin e tyre. |
| (iii) Main issues identified by stakeholders | Problematikat kryesore të konstatuara nga grupet e interesit janë besimi i pakët që qytatarët kanë ndaj institucioneve me të cilat përballen; rritjen e bashkëpunimit me universitetet dhe shoqëritë civile; rritjen e efikasitetit në dhënien e përgjigjeve ndaj qytetarëve; reduktimin e burokracisë në sistemin e drejtësisë. |
| (iv) Main recommendations from stakeholders? | Të pranishmit e përfshirë në diskutim theksuan rëndësinë e mbështetjes së grupeve në nevojë nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas; Rishikim të legjislacionit duke vendosur fokus tek paditë kolektive, paditë për shuma të vogla; realizimin e trajnimeve për stafin e administratës pranë institucioneve kyçe si gjykatë, prokurori etj. |

IV. Shortcomings Identified & Preparations for Next Consultation

| | Details |
|--|---------|
|--|---------|

| | |
|---|--|
| (i) Limitations in stakeholder attendance | Një pjesë e grupeve të interesit nuk ishin prezentë, shkak i së cilës mund të jetë dhe situata shkaktuar nga Covid-19 dhe pjesëmarrësit eliminojnë pjesëmarrjen fizike. Për këtë arsye takimet e tjera konsultative do të zhvillohen online. |
| (ii) Limitations in stakeholder participation | Për shkak të kohës së limituar jo të gjithë pjesëmarrësit diskutuan. Mendimet e tyre do të merren me email. |
| (iii) What can be done to improve attendance? | Për të patur një proces sa më gjithëpërfshirës dhe transparent është e nevojshme pjesëmarrje e lartë e grupeve të interesit, kontributet e të cilëve do të vlejë për të finalizuar me sukses draftin e planit të veprimit lidhur me komponentin nr. 3. Pjesëmarrja e lartë do të lehtësojë procesin duke hedhur hapa konkretë bazuar tek idete, mendimet dhe problematikat të hasura nga grupet e interesit. Për këtë arsye, në rast pamundesie të pjesëmarrjes është kërkuar delegimi i ftesës tek një përfaqësues tjetër i institucionit. |
| (iv) What can be done to improve participation in the next meeting? | Inkurajimin e tyre duke folur direkt me grupet e interesit për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre dhe përfshirjen e ideve dhe sugjerimeve në masat konkrete. |

STAKEHOLDER FEEDBACK

| | | | | | |
|------------------------|---|---------------------------------------|--|------------------|---|
| Name: | Petrina Broka | Organization/ Affiliation: | Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës | Position: | Përfaqësuese e Klinikës së Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë |
| Issues Raised | <input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Pavarësisht arritjes së parashikimit të padive me shuma të vogla, nevojitet përmirësim i legjislacionit.(Dispozitat 399 të Kodit të Prcedures Civile dhe në vijim). Gjithashtu, i kushtoi rëndësi aprovimit të draft ligjit për paditë kolektive i cili është shumë i rëndësishëm për qytetarët. | | | | |
| Feedback | Falenderoi mundësinë e ofruar për të qënë pjesë e këtij procesi dhe kërkoi bashkëpunim në tryeza konsultimi më gjithëpërfshirëse. | | | | |
| Ideas Suggested | <ul style="list-style-type: none"> • Forcimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të Klinikës së Ligjit dhe rrjedhimisht, të grupeve në nevojë, përmes ofrimit të shërbimit ligjor, rritjes së kapaciteteve dhe aftësive praktike të studentëve të Klinikës në dhënien e ndihmës ligjore falas, për shtresat në nevojë duke ju referuar konkretisht bashkëpunimit me Drejtorinë e Ndihmës Ligjore Falas. • Organizimi i kurseve trajnuese për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive, rezultati i të cilit synohet përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, aplikimi i standardeve adekuate gjatë procesit të punës në gjykata dhe prokurori. • Shprehu interes për të qënë pjesë e tryezave dhe bashkëpunim më të madh për konsultime më efektive publike në lidhje me disa projektligje të cilat janë në fazë hartimi, ku konkretisht theksoi projektligjin për arbitrazhin. | | | | |
| Other Comments | <input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes | | | | |

| | | | | | |
|------------------------|--|---------------------------------------|-------------|------------------|---------------|
| Name: | Jozef Shkambi | Organization/ Affiliation: | CRCA | Position: | Jurist |
| Issues Raised | <input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes <ul style="list-style-type: none"> • Theksoi rëndësinë që ka rritja e besimit të qytetarëve tek aksesi në drejtësi • I kushtoi rëndësi pjesës së vonesës që haset në lidhje me fazën e hartimit dhe zbatimit të ligjeve. • Në rrethe të caktuara qytetarët hasen me pamundësinë për zbatimin e ligjit si rrjedhojë e mungesës së kapaciteteve apo problematikave të tjera. | | | | |
| Feedback | Si përfaqësues i CRCA, vlerësoi ftesën dhe e konsideroi si mundësi të vyer për të nxjerrë në pah dhe diskutuar nga afër problematikën me të cilat qytetarët hasen. | | | | |
| Ideas Suggested | <ul style="list-style-type: none"> • Sugjeroi krijimin e mekanizmave për të realizuar matjen e zbatimit të legjislatcionit. | | | | |
| Other Comments | <input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes | | | | |

Government Employee

| | | | | | |
|------------------------|--|---------------------------------------|--|------------------|--------------------|
| Name: | Xhulia Mulla | Organization/ Affiliation: | Drejtoria E Ndhmës Juridike Falas | Position: | Specialiste |
| Issues Raised | <input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes | | | | |
| Feedback | Shpehu falenderim dhe mirënjohje për bashkëpunimin dhe e konsideroi si mundësi të duhur për të patur ura lidhëse mes shoqerive civile dhe rezultat deri në hapin e fundit të procesit. | | | | |
| Ideas Suggested | <input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes | | | | |
| Other Comments | <ul style="list-style-type: none"> • Aktualisht, ka 6 marrëveshje bashkëpunimi me 6 klinika, ku Fakulteti i Drejtësisë ka qënë ndër të parët që ka shprehur interes. • Brenda këtij viti, është planifikuar takim me të gjitha klinikat për rrjedhojë e bashkëpunimit më të plotë. • Janë aktive duke dhënë shërbim 5 qendra, ku synohet brenda këtij viti të jenë funksionale dhe qendra të tjera, konkretisht pranë qyteteve Pogradec, Gjirokastër etj. | | | | |

STAKEHOLDER ATTENDANCE

| | Name | Organization/ Affiliation (full name, not acronyms) | Position | Email |
|----|--|--|---|--|
| 1 | Petrina Broka | Fakulteti I Drejtësisë Universiteti i Tiranës | Përfaqësuese e Klinikës së Ligjit | petrina.br@gmail.com |
| 2 | Drita Avdyli | Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve | Kryetare e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit | dritaavdyli@dhkn.gov.al |
| 3 | Ina Hiri | Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri | Përfaqësuese | inahiri@gmail.com |
| 4 | Nekida Baha | Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri | Avokate | nekida.baha@gmail.com |
| 5 | Jozef Shkambi | Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri | Jurist | fla@crca.com |
| 6 | Xhulia Mulla Government Employee | Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas | Specialist | Xhulia.mulla@drejtësia.gov.al |
| 7 | Ilir Aliaj | Qendra për Zhvillim dhe Demokratizim të Institucioneve | Drejtor Ekzekutiv | Ilir.aliaj@qzhdi-alb.org |
| 8 | | | | |
| 9 | | | | |
| 10 | | | | |
| 11 | | | | |
| 12 | | | | |
| 13 | | | | |
| 14 | | | | |
| 15 | | | | |
| 16 | | | | |
| 17 | | | | |
| 18 | | | | |
| 19 | | | | |
| 20 | | | | |
| 21 | | | | |
| 22 | | | | |
| 23 | | | | |

| | | | | |
|----|--|--|--|--|
| 24 | | | | |
| 25 | | | | |
| 26 | | | | |
| 27 | | | | |